

Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për shkak të bashkimit të familjes duhet bashkëlidhur:

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- dëshmitë mbi marrëdhënien familjare, nëse faktet amzë nuk janë të regjistruar në regjistrin amzë të Republikës së Sllovenisë.

Lutjes për vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për anëtarin familjar madhor¹ është e duhur që pranë dëshmive nga paragrafi paraparak ti bashkëlidhet edhe dëshmia për plotësimin e kushtit të njohjes së gjuhës sllovene në nivelin hyrës A1 sipas Kornizës së përbashkët gjuhësore evropiane, e çka anëtari i familjes mund ta dëshmojë me:

- dëshminë mbi pranimin në arsimim publik të validshëm ose programe studimore në Republikën e Sllovenisë, të cilët zbatohen në gjuhën sllovene;
- dëshminë mbi shkollimin e kryer në çfarëdoqoftë niveli në Republikën e Sllovenisë;
- dëshminë mbi kryerjen e shkollës fillore ose të mesme me program mësimor sllovenë në territoret, në të cilat jetojnë pjesëtarët e bashkësisë kombëtare autoktone sllovene në shtetet fqinje; ose
- dëshminë, se anëtari familjar është më i vjetër se 60 vjet; ose
- me dëftesën mbi provimin e kryer me sukses nga njohja e gjuhës sllovene në nivelin hyrës A1 sipas Kornizës së përbashkët gjuhësore evropiane; ose
- vërtetimin mbi kryerjen e suksesshme të provimit nga komunikimi gojor në sllovenisht në nivelin hyrës A1 sipas Kornizës së përbashkët gjuhësore evropiane në rast të anëtarit familjar madhor, i cili është analfabet; mirëpo komunikon gojarisht në gjuhën sllovene;

Në procedurën njësia administrative sipas detyrës zyrtare do të sigurojë të dhënat në vijim:

- nga regjistri amzë i Republikës së Sllovenisë mbi lindjen ose lidhjes martesore të të huajit në territorin e Republikës së Sllovenisë përkatësisht për faktet tjera amzë, nëse janë të shënuara në regjistrin amzë të Republikës së Sllovenisë;
- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshmimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjykimeve të plotfuqishme përkatësisht

¹ Kushti i njohjes së gjuhës sllovene në nivelin hyrës A1 nuk është i duhur që të plotësohet anëtarit familjar madhor të huajit, i cili është posedues i kartës blu të UE, lejes për qëndrim të përkohshëm për shkak të kryerjes së punës në lëmin e hulumtimeve ose të arsimimit të lartë, lejes për qëndrim të lëshuar në bazë të nenit 38.b të Ligjit për të huajt, lejes unike për personin, të rivendosur brenda shoqërisë ekonomike në bazë të nenit 45.b dhe 45.d të Ligjit për të huajt ose lejes për qëndrim të përkohshëm, nëse kjo është në interes të Republikës së Sllovenisë, lidhur me çka organi, kompetent për lëshimin e lejes, vendos në mbështetje të mendimit të ministrisë kompetente përkatësisht një organit tjetër shtetërorë. Kushti i njohjes së gjuhës sllovene në nivelin hyrës A1 po ashtu nuk është i duhur që të plotësohet anëtarit familjar madhor, i cili për shkak të defekteve shëndetësore, të cilat pamundësojnë komunikimin, nuk është i aftë që ta kryej provimin në formën e kërkuar. Dëshmia mbi plotësimin e këtij kushti tek theksimi i gjendjes faktike të pamundësisë së kryerjes së provimit zbatohet me ekspertin. Shpenzimet, të cilat paraqiten për shkak të zbatimit të kësaj prove janë barrë e të huajit.

aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;

- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkruara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkruara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.